

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

Gjikë Kurtiqi

Djersha Satirike



THE NGJIL  
I MBULLUAR



Gjikë Kurtiqi ka lindur më 3 qershor 1943 në Vithkuq të Korçës. Ka mbaruar fakultetin e shkencave politike juridike dhe tani punon në redaksinë e revistës «Hosteni». Ka disa vjet që boton fejtone, skica, fabula dhe poezi satiro-humoristike në organet e ndryshme të shtypit të përditshëm dhe periodik. Vëllimi «Thëngjill i mbuluar» është vëllimi i tij i parë.



BSH-2  
K98

GJIKË KURTIQI

# THËNGJILL I MBULUAR

Fabula, vjersha satirike, epigrame



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


## **S'PERSËRITET FABULA**

*(Korbi dhe dhelpëra)*

Korbi, kësaj here,  
me mëlçi në gojë,  
tek dega e lisit  
prapë vajti qëndroi.

Korbin, që nga larg  
e pa zonja dhelpër  
dhe pranë iu afrua,  
si te prrall' e vjetër.

— Je një zog i rrallë,  
i bukur nga shtati...  
Por korbi mëlçinë  
me kthetër e kapi:




— Mos u lodh më kot,  
në tjetër kohë jemi,  
veç njëherë ma hodhe  
si desh Lafonteni.

## SA PËR DIJENI

Shkoi në park të kërkonte punë  
një elefant i murmë.

— Që sot — i thanë, — mund të fillosh,  
vendi i ariut është bosh.



Elefanti u prek në sedër  
dhe tha:

— S'mund ta pranoj këtë ftesë,  
e quaj bile ofezë.

— Si të dëshironi,  
i thanë me gjakftohtësi,  
por... sa për dijeni,  
këtu sorkadhe kemi një dhi  
dhe drerin me brirët një pash,  
e bëmë dash.



## DHELPRA DHE FIQTË

Një fabul shkrova,  
e qava me lot,  
për dhelprën dhe fiqtë,  
që s'i kapte dot.

Dhe si u mundua  
e s'mundi t'i zërë  
tha: «S'janë për mua;  
janë të pa bërë».

Dikush i nxituar  
mund ta ngrejë zënë:  
«Fabulën Ezopi  
me kohë e ka thënë».

